



Në përputhje me autorizimin e dhënë në nenin 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, si dhe nenin 25, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 dhjetor 2013 miratoi:

Rregullore

mbi Statistikat e Bilancit të Pagesave dhe Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare

Neni 1 **Qëllimi**

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës për arritjen e objektivave të saj, përpilon dhe publikon statistikat e Bilancit të Pagesave të Kosovës dhe Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare. Qëllimi i Rregullores mbi Statistikat e Bilancit të Pagesave dhe Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare (në tekstin e mëtejme —Rregullorja) është raportimi i statistikave të Bilancit të Pagesave dhe Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare konform standardeve statistikore ndërkombëtare. Rrjedhimisht, Rregullorja definon raportuesit dhe obligimet statistikore të tyre, periudhën e raportimit, statistikat që duhet të raportohen, si dhe konfidencialitetin.

Neni 2 **Përkufizimet**

Për qëllim të kësaj Rregulloreje:

— “BQK” – nënkupton Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

— Bilanci i pagesave (BP) nënkupton informacionin kyç ekonomik që përmbledhë në mënyrë sistematike transaksionet ekonomike të rezidentëve të Kosovës me jorezident, për një periudhë specifike kohore dhe përfshinë të dhëna jokumulative.

— Pozicioni i investimeve ndërkombëtare (PIN) nënkupton vlerësimin e gjendjes kumulative, meqë regjistron gjendjen në fund të një periudhe të caktuar kohore të mjeteve dhe detyrimeve të jashtme financiare, të një vendi të caktuar.

Gjendja në fund të periudhës është rezultat i gjithë transaksioneve që rrjedhin nga e kaluara përfshirë korrigjimet, si pasojë e lëvizjeve në kursin e këmbimit për të llogaritur vlerën e mjeteve/detyrimeve financiare në ditën e raportimit apo ndryshimet në çmimin e tregut.

— “Rezident” nënkupton subjektet juridike që janë të regjistruara dhe që veprojnë në Kosovë si dhe personat fizikë vendbanimi i të cilëve gjendet në Kosovë dhe të cilët nuk largohen nga Kosova për periudhë më të gjatë se një vit (përveç diplomatëve, studentëve dhe pacientëve mjekësor). Me fjalë të tjera, sipas definicioneve të Fondit Monetar Ndërkombëtar, rezident të një vendi të caktuar janë subjektet fizike dhe juridike qendra e interesit ekonomik e të cilëve qëndron në vendin në fjalë.

— “Jorezident” nënkupton çdo person fizikë apo juridik që funksionon në bazë të veprimtarisë së tij në çdo shtet tjetër përveç Kosovës. Degët apo nëndegët e një kompanie jorezidente që veprojnë në Kosovë, janë rezident të Kosovës. Në përputhshmëri me këtë, çdo degë apo nëndegë e një kompanie kosovare që vepron jashtë Kosovës është jorezident i Kosovës.

— “Raportues” nënkupton subjektet juridike të Kosovës të evidentuara nga BQK-ja si transaktorë të mëdhenj dhe të rëndësishëm që të përfshihen në raportim.

— “Transaksion” nënkupton shkëmbimin ekonomik i cili është një ndërveprim ndërmjet njësisë institucionale sipas një marrëveshje të ndërsjelltë ose një veprim brenda një njësisë institucionale që është me rëndësisë analitike për tu trajtuar si një transaksion, kjo shpesh për faktin se njësia është duke operuar në dy nën njësi të ndryshme ekonomike.

Neni 3

Raportuesit

Në pajtim me nenin 25, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, raportues mund të jenë personat fizikë ose juridikë në funksion të statistikave të BP-së dhe PIN-it. BQK-ja, në bazë të kriterëve të caktuara, në mënyrë periodike përcakton mostrën që kërkohet të raportohet. BQK-ja gjithashtu i informon me shkrim dhe nëse është e nevojshme i kontakton, subjektet që janë të përfshira në mostër për mënyrën në të cilën duhet të bëhet raportimi.

BQK-ja për qëllime statistikore sektorizon (klasifikon sipas sektorëve) subjektet juridike konform standardeve statistikore ndërkombëtare të Fondit Monetar Ndërkombëtar, Bankës Qendrore Evropiane, Eurostatit, etj.

Neni 4

Obligimet statistikore të raportuesve

Raportuesit janë të obliguar që t’i ofrojnë informatat që i kërkon BQK-ja me qëllim të përpilimit të statistikave të BP-së dhe PIN-it për Kosovën. Informatat e kërkuara statistikore duhet të jenë të gatshme për BQK-në në formatet e dërguara nga BQK-ja. BQK-ja në parim përcakton subjektet juridike si entitete raportuese. Kjo nënkupton se entitet e përzgjedhura duhet të raportojnë në bazë të pakonsoliduar. Mirëpo, BQK-ja mund të kërkojë raportimin në formë të konsoliduar në

emër të grupit nëse kompanitë e përfshira në raportimin e konsoliduar i përkasin të njëjtit grup. BQK-ja përgatit format dhe udhëzimet për raportim në bazë të standardeve statistikore ndërkombëtare.

Për të gjithë raportuesit që nuk i përmbushin kërkesat statistikore të parapara me këtë Rregullore, Bordi Ekzekutiv i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës do të veprojë në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 5

Periudha e raportimit

Raportet përkatëse duhet të dërgohen në BQK në baza të rregullta periodike. Raportet mujore duhet të dërgohen më së largu 15 ditë kalendarike pas periudhës referuese ndërsa ato tremujore më së largu një muaj pas mbarimit të periudhës referuese.

Nëse statistikat përfundimtare nuk janë në dispozicion brenda këtyre afateve, të dhënat e përkohshme (preliminare) përfshirë vlerësime për zërat e caktuar duhet të dorëzohen në BQK brenda afatit të përcaktuar me këtë Rregullore. Çdo rishikim (revidim) i statistikave nga ana e raportuesve të caktuar duhet të raportohet përsëri në BQK, në momentin kur identifikohet ai revidim.

Neni 6

Raportet statistikore

Raportet statistikore që raportohen në Departamentin e Statistikës të BQK-së kanë të bëjnë me informatat në funksion të BP-së dhe PIN-it, në baza të rregullta periodike. BQK përmes udhëzimeve për raportim definojnë në mënyrë të detajuar raportet statistikore që dorëzohen në BQK. Raportet statistikore që dorëzohen në BQK përmbajnë informatat e prezentuara si në tabelën më poshtë:

Skema e raportimit për grumbullimin e të dhënave me qëllim të përpilimit të statistikave për bilancin e pagesave dhe pozicionin e investimeve ndërkombëtare

Grupi i raportuesve	Emri i raportit	Emri i formularëve raportues	Përmbajta e formularëve
BQK	SRTN	Formulari SRTN	Përmbledhë informata mbi transaksionet e BQK-së dhe të klientëve të BQK-së, të realizuara me botën e jashtme.
Bankat komerciale	SRTN	Faqja e Parë	Përmbledhë informata mbi emrin e institucionit, periudhën raportuese dhe nënshkrimin e zyrtarëve të bankës raportuese dhe nënshkrimin e zyrtarëve të Departamentit të Statistikës.
		Formulari TB	Përmbledhë informata mbi transaksionet e bankës me jo rezidentë të realizuara për qëllime të vetë bankës.

		Formulari TK \geq 10000	Përmbledhë informata mbi transaksionet e klientëve të bankës, të realizuara me botën e jashtme në vlerën 10000 euro e më shumë.
		Formulari TK<10000	Përmbledhë informata mbi transaksionet e klientëve të bankës, të realizuara me botën e jashtme në vlerën nën 10000 euro.
		Formulari TKK	Përmbledhë transaksionet e klientëve të bankave në mes të rezidentëve dhe jo rezidentëve të realizuara me debit ose kredit kartela.
Kompanitë	Anketa e ndërmarrjeve	Faqja e Parë	Përmbledhë informata mbi emrin e institucionit, periudhën raportuese dhe nënshkrimin e zyrtarëve të kompanisë raportuese.
		Formulari 1	Përmbledhë informata të përgjithshme të kompanisë raportuese.
		Formulari 2	Përmbledhë investimet në ekuitet nga investitorët direkt në ndërmarrjen investuese direkte.
		Formulari 3	Përmbledhë të gjitha investimet në jo-ekuitet. Këto detyrime mund të jenë në formë të kredive, depozitave, llogarive të pagueshme, derivateve financiar, instrumenteve tjera financiare, etj.
		Formulari 3	Përmbledhë investimet në ekuitet të kompanisë rezidente në kompani jo-rezidente.
		Formulari 5	Përmbledhë të gjitha investimet në jo-ekuitet. Këto asete mund të jenë në formë të kredive, depozitave, llogarive të arktueshme, derivateve financiar, instrumenteve tjera.
		Formulari 6	Përmbledhë të gjitha transaksionet për blerjen apo shitjen e mallrave ,shërbimeve dhe kompensimi i punëtorëve.
Fondet Pensionale	Anketa e Fondeve Pensionale	Faqja e Parë	Përmbledhë informata mbi emrin e institucionit, periudhën raportuese dhe nënshkrimin e zyrtarëve të kompanisë raportuese.
		Formulari 1	Përmbledhë investimet në ekuitet të fondeve pensionale rezidente tek jo-rezidentët.
		Formulari 2	Përmbledhë investimet në intrumente financiare, përveç atyre në ekuitet, të emtuara nga jorezidentët. Këtu përfshihen investimet në instrumenta të borxhit, depozita, derivativë financiar dhe instrumente tjera financiare jo të cekura më lartë.

Në anketat e ndërmarrjeve dhe të fondeve pensionale, gjendja fillestare dhe ajo përfundimtare e të gjitha pasurive dhe detyrimeve duhet të përputhen, duke marrë parasysh të gjitha lëvizjet në periudhën përkatëse. Kjo nuk do të thotë, megjithatë, se të gjithë zërat duhet të plotësohen patjetër. Ka raste kur të dhënat e kërkuara nuk janë në dispozicion në baza tremujore (p.sh

shpërndarja e dividendës zakonisht bëhet në fund të vitit), pastaj ka raste kur zëra të caktuar nuk janë të zbatueshëm për kompani të caktuar, etj.

Kërkesat për raportime statistikore bazohen në standardet statistikore ndërkombëtare siç janë: Manuali mbi Statistikat e Bilancit të Pagesave dhe Pozicionit Ndërkombëtar të Investimeve - edicioni i gjashtë (anglisht: *Balance of Payments Statistics and International Investments Position Manual – sixth edition*, Fondi Monetar Ndërkombëtar 2008), *Udhëzuesi mbi Statistikat e Bilancit të Pagesave dhe Pozicionit Ndërkombëtar të Investimeve* (anglisht: *Balance of Payments Statistics and International Investments Position Compilation Guide*, Fondi Monetar Ndërkombëtar 2009), *Sistemi i Llogarive Kombëtare 2008* (anglisht: *System of National Accounts 2008*), *Sistemi Evropian i Llogarive Kombëtare dhe Regjionale 95* (anglisht: *European System of Regional and National Accounts 95*).

Për qëllime të BP-së dhe PIN-it, subjektet juridike raportojnë në BQK pasqyrat e audituara financiare (vjetore), konform afatit siç specifikohet në legjislacionin në fuqi.

Neni 7 Konfidencialiteti

Në pajtim me legjislacionin në fuqi, BQK-ja do të respektojë konfidencialitetin në lidhje me të dhënat individuale që i siguron nga subjektet e ndryshme raportuese, dhe do t'i përdorë ato vetëm për qëllime siç është përcaktuar në këtë Rregullore.

Neni 8 Kualiteti i informatave të raportuara

Me qëllim që të dhënat të jenë kualitative, BQK-ja bën monitorimin dhe vlerësimin e kualitetit të të dhënave të dërguara në BQK dhe ndërmerr të gjitha masat që i konsideron të arsyeshme dhe të nevojshme për t'u siguruar, që cilësia e të dhënave të jetë në bazë të standardeve të përcaktuara në formularë.

Neni 9 Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja mbi Statistikat e Bilancit të Pagesave dhe Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare, e miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, me datë 24 nëntor 2011.

Neni 10
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi më 1 janar 2014

Mejdi BEKTASHI

Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës